

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Kuvendi i Kosovës
Mbledhja plenare e Kuyendit
Mbledhja nr. 2002/17
Prishtinë, më 17 tetor 2002, ora 10:10
Ndërtesa e Kuvendit, salla plenare

Procesverbal, tetor 2002

Mbledhjen e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit.
Kryesuesi, pasi konstatoi numrin e deputetëve prezantë në
mbledhje, gjithsej 79, propozoi këtë

R E N D TË D I TË S

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i dytë i:
 - a) Projektligjit për Hipotekat (2002/4),
 - b) Parojetligjit për themelimin e Regjistrat për të drejtat mbi pronën e Paluajtshme (2002/5),
4. Miratimi i emrave të anëtarëve të Komisionit për barazi gjinore dhe atij për persona të zhdukur,
5. Përgjigje në pyetjen e deputetit Arsim Bajrami – drejtuar kryetarit të Kuvendit, PSSP dhe ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi pyeti deputetët e pranishëm se a pajtohen me propozimin e rendit të ditës?

Rangjel Nojkiq diskutoi lidhur me disa incidente që kishin ndodhur në Kllokot, Pejë etj. të cilat reflektohen në gjendjen e sigurisë në bashkësinë serbe. Ai tha se serbët po ftohen të dalin në zgjedhjet e ardhshme lokale, kurse, sipas tij, serbët janë të diskriminuar në institucionet e sistemit. Këtë e ilustroi me shembullin se në komisionet e ekspertëve të hartimit të ligjeve nuk figuron emri i asnjë eksperti serb. Duke pasur parasysh situatën më të re, shtoi ai, duhet të jetë në rend të ditës edhe çështja e sigurisë së

bashkësisë serbe. Ai pati vërejtje lidhur me vonesën e dorëzimit të procesverbalit dhe mënyrën e shkruarjes së tij; në gjuhën shqipe dhe atë serbe, vetëm kur kanë diskutuar deputetët serbë (fjala është për transkript e jo për procesverbal, kjo nënkupton se fjalët e folësit nuk përkthehen – Rregulla 18 dhe 36, paragrafi 2 i Rregullores së punës të Kuvendit).

Kryesuesi tha se z.Nojkiq e dinë se 1/3 e Kosovës nuk kontrollohet nga institucionet e Kosovës. Mund të vëhet në rend dite, tha ai, edhe çështja që e ngriti z. Nojkiq, por vetëm me procedurë të rregullt.

Kryesusi i pyeti deputetët a pajtohen me propozimin e rendit të ditës? Pas numrimit të votave, rezultati ishte:

Për	69
Kundër.....	10
Abstenime.....	0

2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Stojanka Petkoviq tha se procesverbali është përpiluar ashtu sikur kanë folur deputetët dhe kur është fjala tek deputetë që kanë folur në gjuhën shqipe, tha ajo, ne nuk mund ta kuptojmë më saktësi se çka kanë thënë ata. Ajo pati vërejtje edhe sa i përket raportit vjetor të buxhetit dhe memorandumit zyrtar që i është dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe.

Bajrush Xhemajli tha se procesverbali është i nivelit shumë të kënaqshëm, por pati vërejtje në fjalën „programi” siç ishte në procesverbal, e duhej të ishte ”Beograd”, që i referohej kualicionit ”Kthimi”, që ndryshonte kuptimin e diskutimit të tij.

Mevlude Saraçi pati vërejtje në procesverbal se ajo nuk është ndaluar nga policia gjatë fushatës zgjedhore, por ka marrë një ftesë prej policisë në zyrën e saj të punës që të paraqitet në hetuesi.

Xhavit Haliti pati vërejtje tek kryesuesi i mbledhjeve. Ai tha se në bazë të procesverbalit del se në mbledhjen e kaluar, kryesuesi ka pasur 25 disuktime, kurse kanë diskutuar 23 deputetë. Ai ishte i mendimit se kryesuesi nuk ka nevojë t'i komentojë diskutimet e deputetëve, por mund t'ua japë apo merr fjalën dhe t'i vë në votim propozimet.

Slobodan Bjeliq, pati vërejtje në procesverbal (faqën 2) ku përmendet emri i diskutuesit Rangjel Nojkiq, në fakt ishte diskutim i tij.

Sabit Rrustemi pati vërejtje të natyrës së gjuhës dhe lekturës së procesverbalit dhe kërkoi që kjo çështje të përmirësohet.

Sadudin Berisha pati vërejtje në procesverbal, ku thuhet se ”komisioni i ka përkrahur projektligjet në parim dhe natyrisht kundërshtuar nga komisioni”, duhet të jetë „komisioni i ka përkrahur në parim dhe natyrisht ai e ka kryer punën e vet”.

Kryesuesi tha se duhet të përmirësohen të gjitha lëshimet që janë bërë në procesverbal, dhe i pyeti deputetët se kush është që ai të miratohet me vërejtjet e dhëna në te. Pas numrimit të votave rezultati ishte:

Për	76
Kundër.....	3
Abstenime.....	0

3 a). Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Hipotekat

Kryesuesi tha se një mori problemesh po e përcjellin punën normale të Kuvendit. Ai pati vërejtje në punën e komisioneve dhe të deputetëve të Kuvendit. Ai ua tërroqi vërejtjen atyre, në qoftë se në kohë të caktuar nuk kanë mundësi të takohen dhe t'i shqyrtojnë projektligjet, do të konsiderojmë që ai projektligj është miratuar në parim, nuk ka vërejtje dhe amendamente, do të vazhdohet me miratimin e tyre herave tjera.

Kryesuesi tha se Komisioni për buxhet ka bërë një version në gjuhën shqipe të Projektligjit për Hipotekat, që janë vërejtje të natyrës profesionale-gjuhësore dhe disa amendamente i ka bërë Ministria e Shërbimeve Publike dhe ftoi ministrin Krasniqi që t'i arsyetojë ato.

Ministri Jakup Krasniqi tha se amendamentet që i ka propozuar kjo ministri përfshijnë: 1) Preamble i është shtuar Ligjit. Kjo preamble shpreh se projektligji mbi Hipotekat do të jetë objekt i kodit të tokës në të ardhmen, i cili do ta rregullojë çështjen e përgjithëshme lidhur me pronën në Kosovë. 2) Definicione të Projektligjit mbi Hipotekën dhe shprehjet në të i janë përshtatur Projektligjit për Rregjistrin e të drejtave mbi pronën e patundshme, në mënyrë që të sigurojnë koherencën e të dy ligjeve. 3) bartja e hipotekës do të kufizohet në bartjen e kërkësës së siguruar me hipotekë. Këto propozime tha z. Krasniqi e plotësojnë Ligjin për Hipotekën.

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për buxhet për të arsyetuar propozimin e komisionit.

Haki Shatri tha se Komisioni për buxhet e ka rrumbullakësuar punën e tij dhe ka dhënë vërejtje dhe janë korigjuar nga një grup i veçantë i ekspertëve të Kuvendit. Vërejtjet e Komisionit, tha z. Shatri janë përfshirë në tekstin e projektligjit për hipotekat. Amendamentet e PDK-së, tha ai, Komisioni për buxhet nuk ka qenë në gjendje t'i shqyrtojë përsye të mungesës së kuorumi. Komisioni, vazhdoi ai, duhet të mblidhet ad hoc dhe të jep mendimet e veta lidhur me ato amendamente, kurse mendimi i tij personal ishte se ato i begatojnë tekstin e projektligjit dhe rrisin nivelin e tij.

Kryesuesi ftoi deputetën Nerxhivane Dauti që të arsyetojë amendamentet e PDK-së në Projektligjin për Hipotekat.

Deputetja Dauti tha se Projektligji për hipotekat paraqet një bazë të rëndësishme juridike që siguron të drejtat e hipotekës mbi palujtshmërinë dhe i vendos mekanizmat përfshirë e shpejtë dhe efektiv të tëdrexhatave mbi pronën e palujtëshme. Ky projektligj, vazhdoi ajo, përcakton: 1) mjete ekskluzive për krijimin e hipotekave; 2) efektet e tyre juridike ndërmjet palëve dhe personave të tretë; 3) mjetet sipas të cilave hipotekat e caktuara nga organizatat e biznesit mund të ekzekutohen me rrugë jashtëgjyqësore në rast të mospërbushjes sipas kushteve të kërkua të dokumentit të hipotekës.

Anë pozitive e këtij projektligji, tha ajo, është zhvlerësimi i dispozitave të përbajtuara në Ligjin e aplikueshëm që e kanë rregulluar materien në fjalë. Ajo ishte e mendimit se duhet të hartohet një ligj gjithëpërfshisë për pronësi i cili do të siguronte mbulesë të hollësishme të të gjitha të drejtave bazë të pronësisë dhe çështjet lidhur me

pronësinë siç janë: posedimi, servitutet reale, personale, barrët, pengu dhe mjetet juridike për mbrojtjen e tyre. Deputetja Dauti si eksperte e së drejtës detyrimore shtroi iniciativën për procedurën legislative të Kuvendit të Kosovës për këto projektligje: 1) Ligjin e Pronës së Kosovës; 2) Ligjin e Detyrimeve, 3) Ligjin e Procedurës Kontestimore dhe të Përbartimit.

Stojanka Petkoviq tha se deputetët serbë nuk kanë mundur të marrin pjesë në punën e komisioneve për shkak se nuk iu është siguruar transporti. Në mbledhjen e fundit të komisionit për buxhet, tha ajo, nuk ka marrë thirrje dhe luti stafin përgjegjë, që në të ardhmen të sigurohen kushtet e nevojshme të punës.

Nekibe Kelmendi diskutoi për amendamentet për Projektligjin mbi Hipotekat, të propozuara nga Ministria e Shërbimeve Publike. Preambulla është në rregull dhe neni 2 në rregull, tha ajo, mirëpo përkufizimi i termit "hipotekë" është krejtësisht i gabuar.

Bujar Dugolli tha se në mbledhje shtrohen kërkesat, të cilat nuk janë shqyrtaar më parë nëpër komisionet përkatëse të Kuvendit. Kështu ka ndodhur me kërkesat e "Kthimit" dhe të PDK-së, prandaj apeloi tek grupet parlamentare të cilat kanë deputetët në komisionet e Kuvendit, të bashkëpunojnë ndërmjet veti dhe të mos bëjnë amendamente shtesë. Komisioni për shërbime publike, zëvendëskrytar i të cilit është ai, ka bërë disa propozime në Projektligjin për hipotekat dhe Projektligjin për krijimin e Regjistrat, të cilat i paraqiti në vijim: në Projektligjin mbi Hipotekat te nenii 7.2 të shkruhet "një ndryshim i dokumentit të hipotekës do të ketë efekt pas regjistrimit në përputhje me ligjin dhe të hiqet fjala "e zbatueshme". Te nenii 14 të shkruhet: "çdo element tjetër të pajtuar nga pengëdhënsi dhe pengmarrësi që nuk ndalohet me këtë ligj dhe të shlyhet pjesa përfundimtare e cila thotë ose ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm ". Te kapitulli 6 në vend të "dispozitave të përziera" të shkruhet "dispozitat përfundimtare". Te nenii 24, të fshihet fjala "ligj i zbatueshëm " dhe ai nen të formulohet: "me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushojnë së ekzistuari ligjet dhe dispozitat e tjera që më parë kanë rregulluar këtë çështje".

Tomë Hajdaraj tha se ka disa vërejtje parimore në dy projektligjet që po shqyrtohen sot. Por, më shumë ai u përqëndrua në kthimin e dokumentacionit kadastral të Kosovës, i cili gjendet në Serbië, në mënyrë që dihet situata faktikë e regjistrave kadastrale. Kurse sa i përket regjistrave, vazhdoi ai, të bëra gjatë viteve 1989-98, duhet që komisionet t'i shqyrtojnë, sepse janë bërë ndryshime në to dhe ndodh që të ketë 3-4 pronarë të një prone.

Fatmir Sejdiu diskutoi rreth çështjeve parimore lidhur me koordinimin e punëve të Kuvendit. Sot kemi dy versione të projektligjit për Hipotekat, tha ai, dhe kjo mënyrë nuk është në rregull. Në Kuvend mund të debatohet vetëm për një version unik të një projektligji, të cilin duhet pasur parasysh për punën e ardhshme të Kuvendit.

Kryesuesi dha pauzë prej 30 minutave, gjatë së cilës duhet të mblildhen dy komisionet përkatëse për të shyrtuar amendamentet e grupit parlamentar të PDK-së.

Kryesuesi i dëshiroi mirëseardhje z. Hasan Meta, deputet nga LPK-ja i cili zëvendëson të ndjerin Bedrush Çollakun.

Pastaj filloi debati lidhur me amendamentet për Projektligjin për Hipotekat. Bazë për debat ishin propozimet e deputetës Nerxhivane Dauti dhe Ministrisë së Shërbimeve Publike si dhe raportet e komisioneve kryesore dhe funksionale të Kuvendit.

Kryesuesi vazhdoj me procedimin e amendamenteve nen per nen në Projektligjin për Hipotekat , duke filluar nga teksti i preambullës së Projektigjit të propozuar nga Ministria e Shërbimeve Publike, pastaj neni 1.1 me miratim që të hiqet fjala "ekluziv", pastaj nenit 2. që i referohej përkufizimeve të termave "parcellë e pronës", "hipotekë", "zyrë e regjistrimit " dhe "prona tregtare", të cilat u miratuan sipas tekstit të propozuar dhe të miratuar nga komisionet.

Në vazhdim u miratua amendamenti në nenin 3, 3.3 dhe 3.4 sipas tekstit të propozuar; amendamenti në nenin 4.2, 4.4, 4.5 dhe 4.7 sipas tekstit të propozuar. Po ashtu u miratuan amendamentet e propozuara dhe të miratuara nga komisionet e Kuvendit lidhur me nenin 5 pika (k), nenin 6.1, 6.2 dhe 6.3. Lidhur me amendamentet e propozuara nga nenin 7 pika 1 dhe 2 u miratuan amendamentet e Ministrisë së Shërbimeve Publike, ndërsa në nenin 8 dhe 8.1 u miratuan amendamentet e deputetës Nerxhivane Dauti dhe amendamenti sipas tekstit të propozuar në nenin 8.2, 8.3 dhe 8.4. Në vazhdim u miratuan amendamentet e propozuara në nenin 10. 4, nenin 11, 12.1, 14 (d) dhe (g) amendamenti në nenin 15.1, 15.2 dhe 15.3; amendamenti në nenin 17.1, 17.3, 17.5 dhe 17.6; amendamenti në nenin 18.1 dhe 18.2; amendamenti ne nenin 19.1, 19.2 dhe 19.3; amendamenti në nenin 21.1 dhe 21.2 teksti i propozuar nga Ministria e Shërbimeve Publike; amendamenti në nenin 22.1 (a) dhe (b); Në vazhdim u miratuan amendamentet e Komisionit për shërbime publike, Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve lidhur me riformulimin e nenit 24 dhe nenit 25 të projektligjit për hipotekat dhe që dispozitat përfundimtarë duhet të jenë unike në të gjitha ligjet.

Në propozim të kryesuesit u dha në votim teksti i projektligjit në tërësi.

Rezultati i votimit ishte;

Për 69,
Kundër..... 2,
Abstenuan8,

Kryesuesi konstatoi se u miratua Ligji për Hipotekat.

3 b). Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Regjistrit të të drejtave të pronës patundshme.

Kryesuesi propozoi procedimin sipas amendamenteve të miratuarë në komisionet e Kuvendit, që kishin të bënин me nenin 4.1, nenin 6.1, në nenin 9 dhe me nenin 10 të projektligjit. Amendamentet e propozuara u miratuan pa vërejtje. Pastaj u kalua në votimin e Ligjit në tërësi dhe rezultati ishte;

Për.....69,
Kundër... 11,
Abstenime 0,

Kryesuesi konstatoi miratimin e Ligjit për themelimin e Rregjistri për të drejtat mbi pronën e paluejtshme.

4. Emrimi i anëtarëve të Komisioneve për barazi gjinore dhe i atij për personat e zhdukur.

Kryesuesi tha se deputetët i kanë marrë emrat e anëtarëve të Komisionit për barazi gjinore; 1. Melihate Tërmkolli, 2. Hatixhe Hoxha, 3. Nimon Alimusa, 4. Gjylishene Berisha, 5. Remzie Nimani, 6. Sala Ahmetaj, 7. Sabit Rrustemi dhe 8. Sebahate Grajçevci. Për Komisionin e personave të zhdukur: 1. Flora Brovina, 2. Sanije Aliaj, 3. Rangjel Nojkiq, 4. Mevlýde Saraçi, 5. Besa Gaxheri, 6. Qazim Kabashi, 7. Ibush Januzi, 8. Berat Luzha dhe 9. Zylfije Honduzi. Kryesuesi dha në votim këtë propozim dhe rezultati ishte;

Për 80,

Kundër.... 0

Abstenime..0.

Kryesuesi konstatoi se u miratuan anëtarët e propozuar për Komisionin për barazi gjinore dhe atë për persona të zhdukur.

5. Përgjigje në pyetjen e deputetit Arsim Bajramit – drejtuar kryetarit të Kuvendit, PSSP dhe ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Arsim Bajrami edhe njëherë e shtroi çështjen e Ligjit për arsimin e lartë, të cilin e ka miratuar Kuvendi i Kosovës, por ende nuk është shpallur nga PSSP. Ky ligj, tha ai, bënë pjesë në sferën e kompetencave që janë bartur tek autoritetet e Kosovës. Në bazë të Rregullës 9.4 ligjet të cilat i miraton Kuvendi i Kosovës i nënshkruan kryetari i Kuvendit dhe i përcjell për procedim dhe shpallje tek PSSP. Ky ligj nuk prek në kompetencat e rezervuara dhe nuk është dashur të komplikohet procedura. Ai apeloi te autoriteti i kryetarit të Kuvendit që të ndërrmarrë gjithçka që është e mundur, që ai ligj të shpallet sa më ëshpejt.

Ministri Rexhep Osmani tha se deputeti Bajram, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, me këtë pyetje; Pse nuk është dekretuar ligji për Arsimin e lartë? Ministria e Arsimit, tha z.Osmani e ka kryer punën e vet. Këtë pyetje duhet shtruar Kuvendit të Kosovës. Unë e kam shtruar disa herë ktëtë çështje, vazhdoi z. Osmani, por informatat që i kam, thonë se ai Ligj nuk i është dorëzuar Zyrës ligjore të PSSP dhe ai nuk e ka parë për nënshkrim. Mirëpo, vazhdoi ai, sipas deklaratës së zëdhënses së UNMIK-ut mbrëmë, del se ka probleme rrëth çështjes së nënshkrimit të Ligjit për Arsimin e lartë. Unë, tha ai, si ministër i Aarsimit nuk kam marrë asnje hap pa dekretimine atij Ligji, me që nevojitet një procedurë e tillë. Me procedurat që kanë rrjedhë, vazhdoi ai, lidhur me atë çështje, kanë qenë të tillë që deri më 26 shtator, kur është kryer edhe diskutimi për propozimin e panelit të veçantë, propozimi i kryesuesit të panelit, jo i panelit, pas vendimit të Kuvendit të Kosovës, mendoj se çdo gjë ka përfunduar sa i përket miratimit të tij. Kisha dëshiruar, tha ai, që të mos ketë konflikte rrëth nënshkrimit të këtij Ligji dhe Ministria e Arsimit nuk mund ta kryejë veprimtarinë e sajë nëqoftëse nuk ka ligje të dekretuara. Ne kemi qenë, tha ai, të disiplinuar, kemi qenë korrekt dhe nuk kemi nxjerrë asnjë akt përcjellës deri më tanë.

Kryesuesi tha se menjëherë pas përfundimit të procedurës parlamentare Ligji i është dërguar me kohë dhe unë kam kërkuar kopjen e shkresës dhe sekretari më ka

njoftuar për kohën, orën dhe minutën e saktë se kur Ligji ka arritur në Zyrën e PSSP, prandaj çdo informatë se Ligji nuk është dorëzuar me kohë nuk qëndron.

7. Të ndryshme

Tomë Hajdaraj shtroi çështjen e nxjerrjes së Ligjit për pylltarinë nga Kuvendi i Kosovës. Ai këtë e arësyetoi me faktin se po bëhet shkatrrimi masiv i pyjeve të Kosovës Në sezonin vjeshtor.

Lirak Çelaj diskutoi rreth problemit të materieve me elemente radioaktive në regionin e Mitrovicës dhe kërkoi ndihmën e TMK-së, SHPK-së, UNMIK-ut dhe KFOR-it për të zgjidhur këtë çështje.

Gani Prekopuca shtroi problemin e numrit të votuesëve serbë në Fushë Kosovë. Ai, tha se, në këtë komunë tanë ka mbi 5000 votues të komunitetit serbë që nuk kanë qenë më parë të regjistruar dhe sipas të gjitha statistikave të asaj komune, ai shtim i votuesëve nuk qëndron. Ai pyeti se cilat burime të të dhënave janë shfrytëzuar lidhur me atë rast, kur diheet se UNMIK-u nuk u ka lëshuar asnjë letërmjoftim dhe ekziston mundësia e manipulimit me rastin e zgjedhjeve të ardhëshme.

Kryesuesi tha se edhe në Kryesinë e Kuvendit e kemi shqyrtuar një informatë të tillë dhe shqetësimet tona ia kemi përcjellë ambasadorit Fieski. Ju e dini, vazhdoi ai, se edhe këto zgjedhje organizohen nga OSBE-ja dhe institucionet tjera ndërkombëtare.

Mbledhja përfundoi në orën 12.50

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
Akademik Nexhat Daci